



Konferenca e Dytë Shkencore, 12-13 Dhjetor

PERFORMANCA MJEDISORE DOMOSDOSHMËRI E AUDITEVE ADMINISTRATIVE

Prof. Assoc. Dr. Sazan **GURI***

Ekspert mjedisi & Pedagog në të Drejtën e Mjedisit,
e-mail: sazanguri@gmail.com

MSc. Marianthi **GURI****

Eksperte mjedisi, G & G Group
e-mail: info@gggroup-al.com

ABSTRAKT

Administrimi publik mjedisor, sipas ligjit, ka për qëllim t'i shërbejë si qytetarisë, ashtu edhe interesit mjedisor. Prandaj, thirrja në bashkësinë ndërpersonale kërkon të ekzistojë realisht lidhja e së drejtës së mjedisit, me të drejtën civile, me të drejtën administrative, por edhe me të drejtën penale. Analiza mjedisore është shpesh pjesë e përbashkët e punës së një juristi dhe e një mjedisor. ¹ Por, në ditët e sotme ka ende shumë ekspertë të fushës juridike, të cilët nuk kanë kontakte të drejtpërdrejta me të dhënat mjedisore. Dëmet ndaj mjedisit kryhen nga subjekte të ndryshëm të shoqërisë sonë, duke shkelur parimin e përgjegjshmërisë dhe mbrojtjes së interesave të publikut. Ato sjellin çënim të të drejtave të shtetasve dhe si të tilla duhet që patjetër të jenë subjekt i rregullave ligjore administrative, por edhe i ligjit penal.

FJALË KYÇE

Administrimi publik mjedisor, e drejta mjedisore, vetëdije mjedisore, krimi mjedisor.

¹ Guri S., M. Guri, K. Koçi. *E drejta mjedisore: Bazat e legjislacionit krahasimor mjedisor shqiptar dhe evropian*. "Marin Barleti". Tiranë, 2010